



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALËSI E MADHE

DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr 332 Prot.

Koplik, me 15/10 /2021

PROJEKT- VENDIM

NR ____, DATË ___/___/2021

“PER TRANSFERIMIN E FONDIT PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË KRONIT TË BOGËS“

Keshilli Bashkiak në mbledhjen e tij te datës ___/___/2021, me propozim të kryetarit të bashkisë dhe në mbështetje të nenit 9, nenit 54 gërma dh, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, në nenin 44 dhe 48 të ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të neneve 5,20 dhe 21 të ligjit nr.8561 dt. 22.12.1999, “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim te Perkohshëm te Pasurisë Pronë Private Për Interes Publik“, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554 dt. 29.09.2021 “Për Shpronësimin Për interes Publik të Personave të Pasurive të Paluajtshme, Pronë Private, që Preken nga Realizimi i Projektit “Rikualifikimi i Sheshit të Kronit të Bogës“:

PROPOZOJ

1. Të miratojë transferimin e fondit për shpronësim publik në vlerën 185,474 (njëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

Pakësime:

Gr.00 Kap.05 Prog.01110 Llog.ek.231 (Investime Kapitale)

-185,474 lekë

Shuma

- 185,474 lekë

Shtesa:

Gr.00 Kap.05 Prog. Ek. 04520 llog. Ek. 231

+185,474 lekë

Shuma

+ 185,474 lekë

2. Vlera e shpenzimeve procedurale 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Malësi e Madhe, Gr. 00 Kap. 01 Prog.01110 "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi", Llog. Ek. 602.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Konceptoi: Aida Curraj (Përgjegjës Buxheti)

Miratoi: Altin Rrukaj (Drejtor i Financës dhe Buxhetit)



VENDIM
Nr. 554, datë 29.9.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I
SHESHIT TË KRONIT TË BOGËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i sheshit të Kronit të Bogës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 185 474 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 185 474 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Malësi e Madhe.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Malësi e Madhe.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

8. Bashkia Malësi e Madhe të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Malësi e Madhe.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë regjistrimin e kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama